



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik BRT Pharm SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna emergjente", me numër identifikues: 632-24-9652-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-108-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e vonuar- pas afatit, Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik BRT Pharm SH.P.K., e dt.31.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me barna emergjente", me numër identifikues: 632-24-9652-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-108-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 23.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 23.10.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.31.10.2024, Operatori ekonomik BRT Pharm SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me barna emergjente", me numër identifikues: 632-24-9652-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-108-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, nuk ka bërë pezullimin e lëndës, sepse Operatori ekonomik ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim pas afatit ligjor(neni 60 paragrafi 60.1 nën b, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022).

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ka vepruar në pajtim me nenin 21, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, prandaj kërkesa për rishqyrtim përpos që është e vonuar, është edhe e pabazuar .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës